

ANALIZË EPIDEMIOLOGJIKE E RASTEVE POZITIVE ME INFLUENCË SEZONALE NË KOSOVË GJATË SEZONIT 2023/2024 DHE IMPLIKIMET NË SHËNDETIN PUBLIK



Miranda Lutfiu- Sahiti

Doktor i Mjekësisë

Abstrakt

Hyrje

Influenca Sezonale mbetet një ndër infeksionet më të shpeshta virale gjatë muajve të ftohtë, duke kontribuar në rritje të ndjeshme të morbiditetit të rasteve me sëmundje respiratore. Monitorimi i tipologjisë së virusëve dhe prania e bashkëinfeksioneve mbetet esencial për përgatitjen dhe reagimin e sistemit shëndetësor.

Qëllimi

Ky studim synon të analizojë situatën epidemiologjike të rasteve pozitive me Influençë Sezonale në Kosovë gjatë sezonit 2023/2024, përmes vlerësimit të përhapjes së Influençës A dhe B, shpërndarjes demografike dhe pranisë së bashkëinfeksioneve me patogjenë të tjerë respiratorë.

Metodologjia

Është realizuar një analizë retrospektive e të dhënave laboratorike të mbledhura nga IKSHPK gjatë periudhës tetor 2023 – maj 2024. Mostrat janë testuar për virusët e Influençës A dhe B, SARS-CoV-2, Virusin Sintical (RSV), Human Adenovirus (ADV), Human Rhinovirus (HRV), Human Metapneumovirus (MPV) dhe Parainfluenza virus (PIV). Të dhënat janë përpunuar përmes metodave statistikore për të analizuar shpërndarjen sipas moshës, gjinisë dhe komunës.

Rezultatet

Nga 2,916 mostra të testuara, janë konfirmuar 258 raste me Influençë A dhe B (pozitivitet 12.91%). Sipas tipit: me Influençë A (228 raste apo 11.41%) dhe Influençë B (30 raste apo 1.5%). Dominimi i Influençës A ishte i dukshëm. Janë identifikuar

gjithsej 16 raste me bashkëinfeksione, kryesisht me Adenovirus, SARS-CoV-2 dhe RSV. Grupmoshat 0–4 vjeç dhe 60+ vjeç ishin më të prekura. Shumica e rasteve pozitive u raportuan në komunat urbane.

Diskutim

Të dhënat janë në përputhje me trendet ndërkombëtare për dominimin e Influençës A. Numri i ulët i bashkëinfeksioneve sugjeron qarkullim të kufizuar të patogjenëve të tjerë ose mungesë të testimit të gjerë të kombinuar. Gjetjet theksojnë rëndësinë e forcimit të mbikëqyrjes epidemiologjike virologjike dhe përmirësimit të diagnostikimit laboratorik.

Përfundim

Ky studim ofron një pasqyrë të rëndësishme mbi situatën e gripit sezonal në Kosovë dhe rekomandon zgjerimin e mbikëqyrjes epidemiologjike, përmirësimin e infrastrukturës laboratorike dhe edukimin e popullatës për të rritur ndërgjegjësimin ndaj gripit sezonal dhe komplikimeve të tij.


Fjalët kyçe

Influenca Sezonale, Kosovë, mbikëqyrje epidemiologjike virologjike, Influenca A, bashkëinfeksione, epidemiologji.

Hyrje

Infeksionet respiratore akute përfaqësojnë një nga sfidat më të mëdha të shëndetit publik në nivel global, veçanërisht gjatë stinës së dimrit. Nga këto, Influenca sezonale mbetet një nga shkaktarët më të shpeshtë të morbiditetit dhe mortalitetit, duke prekur çdo vit rreth 5–10% të të rriturve dhe 20–30% të fëmijëve në mbarë botën [1]. Organizata Botërore e Shëndetësisë

Mbikëqyrja virologjike nga Qendrat Sentinel në Influençë A dhe B, RSV dhe patogjenët tjerë respiratorë në IKSHPK, sezona 2023/2024



Grafikoni 1. Mbikëqyrja virologjike nga Qendrat sentinel në Influençë A dhe B, RSV dhe patogjenët e tjerë respiratorë në IKSHPK, sezona 2023/2024

Grafikoni 1. Mbikëqyrja virologjike nga Qendrat sentinel në Influençë A dhe B, RSV dhe patogjenët e tjerë respiratorë në IKSHPK, sezona 2023/2024

Korrespondenca:
miranda.lutfiu@gmail.com

ANALIZË EPIDEMIOLOGJIKE E RASTEVE POZITIVE ME INFLUENCË SEZONALE NË KOSOVË GJATË SEZONIT 2023/2024 DHE IMPLIKIMET NË SHËNDETIN PUBLIK



Arijana Osmani-Kalaveshi

Specialist i Epidemiologjisë

(OBSh) raporton se influenza kontribuon në 290,000 deri në 650,000 vdekje çdo vit si pasojë e ndërlikimeve respiratore [2].

Virusi i Influcencës ndahet në dy tipe kryesore që prekin njerëzit: Influenca A dhe Influenca B. Tipi A është përgjegjës për shumicën e epidemive dhe pandemive historike, ndërsa tipi B shkakton shpërthime më të kufizuara gjeografikisht dhe më pak të rënda klinikisht [3].

Në Kosovë, mbikëqyerja e gripit realizohet nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHPK), në bashkëpunim me qendrat sentinel dhe josenitel të shëndetit publik në rajone dhe përmes qendrave të Kujdesit Primar Shëndetësor. Megjithatë, sfida të rëndësishme vazhdojnë të ekzistojnë. Këtu përfshihet shkalla shumë e ulët e vaksinimit, mungesa e informimit të popullatës dhe kapaciteti i kufizuar për diagnostikim të shpejtë virologjik [4].

Në krahasim me vendet e rajonit, si Shqipëria apo Maqedonia e Veriut, Kosova raporton një numër më të vogël të vaksinimeve kundër gripit sezonal. Për shembull, gjatë sezonit 2022/2023, shkalla e vaksinimit në Shqipëri ishte rreth 6.5%, ndërsa në Kosovë mbeti nën 2% [5]. Ndërkohë, vendet e Bashkimit Evropian arrijnë norma shumë më të larta: në Itali dhe Gjermani, për shembull, mbulimi me vaksinë i personave mbi 65 vjeç tejkalon 50% [14].

Ky studim synon të analizoj në kuptim statistikor dhe epidemiologjik shpërndarjen e rasteve pozitive me viruset e influencës gjatë sezonit 2024/2025 në Kosovë. Përmes kësaj analize, ofrohet një vlerësim i qartë i tipizimit viral, statusit të vaksinimit, dhe prezencës së bashkëinfeksionit me patogjenë të tjerë respiratorë, duke kontribuar në përmirësimin e

strategjive të mbrojtjes shëndetësore publike dhe kapaciteteve të përgjigjes së sistemit shëndetësor.


QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të ofroj një vlerësim të detajuar epidemiologjik të rasteve pozitive me virusin e Influcencës A dhe B në Kosovë gjatë sezonit 2023/2024, duke u mbështetur në të dhëna të mbledhura në mënyrë sistematike nga Insituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK).

Nëpërmjet kësaj analize, synohet të vlerësohet struktura demografike e të prekurve, dominimi i nëntipeve virale, shkalla e vaksinimit, si dhe prania e bashkëinfeksioneve me patogjenë të tjerë respiratorë (p.sh. SARS-CoV-2, RSV). Të dhënat e grumbulluara janë jetike për formulimin e politikave efektive të shëndetit publik, si dhe për përgatitjen e përgjigjeve emergjente ndaj shpërthimeve sezonale gripoze, në përputhje me rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Qendrës Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC) [7,8].

Qëllimet specifike të këtij studimi përfshijnë:

- Të përcaktohet incidenca dhe përqindja e rasteve pozitive me Influcencë A dhe Influcencë B gjatë sezonit 2023/2024 në Kosovë
- Të vlerësohet shkalla e vaksinimit kundër gripit sezonal
- Të analizohet shpërndarja demografike e rasteve sipas grupmoshave, gjinisë dhe rajonit gjeografik (komuna).
- Të identifikohet prania e bashkëinfeksioneve me patogjenë të tjerë respiratorë si SARS-CoV-2 dhe



Grafikoni 2. Rastet e konfirmuara me Influcencë A dhe B në Kosovë, sezona 2023/2024 të ndara sipas grup-moshës

Grafikoni 2. Rastet e konfirmuara me Influcencë A dhe B në Kosovë, sezona 2023/2024 të ndara sipas grup-moshës

ANALIZË EPIDEMIOLOGJIKE E RASTEVE POZITIVE ME INFLUENCË SEZONALE NË KOSOVË GJATË SEZONIT 2023/2024 DHE IMPLIKIMET NË SHËNDETIN PUBLIK



Pranvera Kaçaniku-Gunga

Specialist i Epidemiologjisë

virusi respirator sincial (RSV)

•Të ofrohen rekomandime të bazuara në evidencë për përmirësimin e sistemit të mbikqyrjes epidemiologjike virologjike dhe strategji për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e vaksinimit në Kosovë

Zbatimi i këtyre qëllimeve synon të ndihmojë institucionet shëndetësore të Kosovës në përmirësimin e kapaciteteve të tyre për parandalimin, zbulimin e hershëm dhe menaxhimin efektiv të influencës sezonale në të ardhmen.

MATERIALE DHE METODOLOGJIA

Dizajni dhe të dhënat e studimit:

Ky është një studim retrospektiv deskriptiv me karakter epidemiologjik, ai analizon të dhënat laboratorike dhe klinike të mbledhura nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës gjatë sezonës 2023/2024, për periudhën tetor 2023 – maj 2024. Qëllimi është të përshkruhet shpërndarja e rasteve pozitive me viruset e Influcencës A dhe B.

Burimi i të dhënave: të dhënat janë mbledhur nga paneli respirator viral i laboratorit qendror të virologjisë në IKSHPK. Ky panel përfshin analizën simultane për virusët respiratorë më të shpeshtë: Influenca A, Influenca B, SARS-CoV-2 dhe virusi respirator sincial (RSV). Mostrat janë marrë nga pacientë me simptoma të infeksioneve akute të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes (ARI/ILI), sipas definicioneve të OBSH dhe ECDC [7,8].

Popullata e përfshirë në studim: në studim janë përfshirë të gjitha mostrat e testuara për Influcencë sezonale në laboratorin qendror të IKSHPK-së gjatë sezonës përkatëse. Për secilën

mostër janë mbledhur këto të dhëna:


- Gjinia dhe mosha e pacientit
- Komuna dhe institucioni referues
- Rezultatet laboratorike për secilin virus
- Statusi i vaksinimit kundër gripit sezonal
- Prania e simptomave klinike, data e fillimit të simptomave dhe data e hospitalizimit, kur ishte e disponueshme
- Shkalla e mbulueshmërisë me vakcina.

Të dhënat janë përpunuar dhe analizuar në mënyrë numerike dhe grafike duke përdorur Excel dhe Python. Metodatat kryesore të analizës përfshijnë:

- Analizë përshkruese e shpërndarjes së rasteve pozitive sipas llojit të virusit
 - Klasifikim demografik sipas gjinisë, grupmoshës dhe komunës
 - Krahasim midis individëve të vaksinuar dhe të pavaksinuar
 - Identifikim i bashkëinfeksioneve (co-infections) me virusë të tjerë respiratorë
 - Vizualizim i të dhënave përmes grafikëve dhe tabelave për të ilustruar trendet sezonale
- 3.5. Kufizimet metodologjike të studimit: Të dhënat e përpunuara përfaqësojnë një burim të vlefshëm për vlerësimin e trendit të Influcencës sezonale dhe japin kontribut domethënës në forcimin e mbikqyrjes epidemiologjike në shëndetësinë publike në Kosovë.

REZULTATET

Gjatë sezonës 2023/2024 në Kosovë, nga



Grafikoni 3. Rastet pozitive me Influcencë A dhe B, sipas komunave dhe Incidenca në Kosovë, sezona 2023/2024

Korrespondenca:
pranvera.kacaniku@rks-gov.net

Grafikoni 3. Rastet pozitive me Influcencë A dhe B, sipas komunave dhe Incidenca në Kosovë, sezona 2023/2024

gjithsej 2,916 mostra të testuara për virusë respiratorë, 258 (12.91%) rezultuan pozitive për Influcencë, me dominim të lartë të tipit A (11.41%) krahasuar me tipin B (1.5%). Shumica e rasteve u regjistruan në muajt janar dhe shkurt, duke reflektuar kulmin sezonal të qarkullimit viral. U identifikuan gjithsej 16 raste me bashkë-infeksione, ku Adenovirusi përbënte shumicën (n=10), ndërsa SARS-CoV-2 dhe RSV ishin më të rrallë. Këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e mbikëqyrjes virologjike të qëndrueshme dhe të integruar (Grafikoni 1). Kjo tregon për dominimin e qartë të Influcencës A, në përputhje me trendet e raportuara globalisht nga OBSH për sezonin 2023/2024 [11].

Analiza demografike dhe klinike: shumica e rasteve pozitive janë raportuar nga qendrat urbane, veçanërisht nga Prishtina, ku 66.6% e rezultateve pozitive për Influcencë A ishin nga ky rajon, krahasuar me numrin e testimeve i cili përfshinte 7.61% të numrit të përgjithshëm të tyre, gjë që mund të lidhet me qasjen më të mirë në testim. (Grafikoni 3).

Të dhënat tregojnë se grupmosha më e prekur nga Influenca A ishte ajo 0–4 vjeç (27.63%), pasuar nga 60+ (21.93%) dhe 45–60 vjeç (15.79%). Ndërsa për Influcencën B, incidenca më e lartë u regjistrua te grupmoshat 5–14 vjeç (33.33%) dhe 15–29 vjeç (26.67%). Kjo shpërndarje tregon një dominim të Influcencës A te të vegjlit dhe


të moshuarit, ndërsa Influenca B përhapet më shumë te moshat e reja dhe fëmijët në moshë shkollare. Këto rezultate sugjerojnë nevojën për masa të synuara mbrojtëse sipas grupmoshave. Tabela 1. (Grafikoni 2).

Nuk u evidentua asnjë bashkë-infeksion i virusit të Influcencës A me atë të Influcencës B. Një rast pozitiv i bashkë-infeksionit të virusit të Influcencës A me SARS Cov-2. Po ashtu, nga një bashkë-infeksion me Human Rhinovirus, Metapneumovirus dhe virusë të tjerë (OC43, NL63, 229E, HKU1). Kurse si bashkë-infeksion me Adenovirus rezultuan 10 raste. Tabela 2.

Brenda nëntipeve të Influcencës A, u identifikua A(H1N1)pdm09 me 13% të rasteve, ndërsa sub-tipi B/Victoria nuk rezultoi në asnjë rast pozitiv (0%). Ky dominim i Influcencës A, veçanërisht i nëntipit A(H1N1)pdm09, është në përputhje me tendencat virologjike të raportuara nga vendet e tjera të rajonit dhe OBSH. (Grafikoni 4).

Statusi i vaksinimit: Nga data 9 tetor 2023 deri me 14 prill 2024 janë administruar gjithsej 69,597 doza të vaksinës kundër gripit sezonal në nivel vendi (shpenzueshmëria 81.87% e dozave). Sa i përket grupeve të rrezikut, mbulueshmëria më e lartë me vaksinim i përket qytetarëve mbi 65 vjeç me 47,868 ose 25.13%, me gjendje të caktuara shëndetësore 20,862, punëtorë shëndetësor 1,220 ose 5.08 % , gra shtatëzëna 11 ose 0.05%. Kjo shkallë e ulët në Kosovë mund të jetë rezultat i mungesës së fushatave informuese, furnizimit të pamjaftueshëm me vakcina, si dhe perceptimeve të gabuara publike mbi rëndësinë e vaksinimit. (Tabela 3).

RASTET E KONFIRMUARA ME INFLUCENCË A DHE B NË KOSOVË, SEZONA 2023/2024 SIPAS SUB-TIPIT



Grafikoni 4. Rastet e konfirmuara me influencë sipas nëntipit

Tabela 1. Rezultati i rasteve të testuara pozitivisht për Influcencë A dhe Influcencë B sipas grupmoshave.

Grupmosha	Influenza A	Influenza B	Përqindja e testimeve
0-4	27.63%	20.00%	26.74%
5-14	14.91%	33.33%	17.05%
15-29	6.14%	26.67%	8.53%
30-44	13.60%	13.33%	13.57%
45-60	15.79%	3.33%	14.34%
60+	21.93%	3.33%	19.77%
Totali	100.00%	100.00%	100.00%

Tabela 2. Rezultati i bashkë-infeksioneve të Influcencës A me virusët e tjerë

Bashkë-infeksionet e Influcencës A me patogenët tjerë respirator	
Virusi	Numri i rasteve
Influenza B	0
SARS COV 19	1
Human rhinovirus	1
Metapneumovirus	1
RSV tip A	2
RSV tip B	0
Adenovirus	10
Virusët e tjerë (OC43, NL63, 229E, HKU1)	1
TOTAL	16

Tabela 3. Vaksinimi kundër gripit sezonal sipas grupeve të rrezikut

Grupet e rrezikut	Të vaksinuar
Mbi 65 vjeç	47868
Me gjëndje të caktuara shëndetësore nën 65 vjeç	20862
Punëtoret shëndetësorë	1220
Gratë shtatëzëna	11
Total doza të administruara	69597

Referencat:

1. Iuliano AD, Roguski KM, Chang HH, et al. Estimates of global seasonal influenza-associated respiratory mortality: a modelling study. *Lancet*. 2018;391(10127):1285–1300.
2. World Health Organization. Influenza (Seasonal). WHO Fact Sheets. 2023. [[https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/influenza-\(seasonal\)](https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/influenza-(seasonal))]
3. Paules C, Subbarao K. Influenza. *Lancet*. 2017;390(10095):697–708.
4. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës. Raporti vjetor i aktiviteteve për sezonin 2022/2023.
5. ISHP Shqipëri. Raport mbi vaksinimin sezonal kundër gripit, 2023.
6. European Centre for Disease Prevention and Control (ECDC). Seasonal influenza vaccination and antiviral use in EU/EEA Member States – Overview of influenza surveillance systems in Europe. ECDC Report 2022.
7. World Health Organization. Global Influenza Programme: Surveillance standards for influenza. WHO; 2022.
8. European Centre for Disease Prevention and Control. Seasonal influenza – Surveillance overview. ECDC Technical Report 2023.
9. World Health Organization. WHO Global Influenza Surveillance and Response System (GISRS): Manual for the laboratory diagnosis and virological surveillance of influenza. WHO; 2022.
10. European Centre for Disease Prevention and Control. Surveillance of influenza and other respiratory viruses in the EU/EEA. ECDC; 2023.
11. World Health Organization. Influenza Update – Global summary. WHO Weekly Epidemiological Record. March 2025.
12. ISHP Shqipëri. Raport vjetor për mbulimin me vaksina sezoni 2024/2025.
13. Instituti për Shëndet Publik – Maqedonia e Veriut. Raport për gripin sezonal 2024/25.